



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Primi/Prudato Received / Delivery	20.05.2022	viti god year	2
Organ / Njësia Organ / Jedinica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPMSTKK	2957/2022		115



## Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.350/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti-kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Jeton Koca-anëtarë, si dhe Sabile Avdyli-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.350/2022 të datës 08.04.2022 të parashtruar nga ankuesi \_\_\_\_\_, me adresë \_\_\_\_\_ kundër organit të punësimit ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregëtisë në çështjen juridike "masë disiplinore", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 20.05.2022 mori këtë:

### V E N D I M

I.Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.350/2022 e datës 08.04.2022 e parashtruar nga ankuesi \_\_\_\_\_

II.Mbetet në fuqi vendimi me numër protokollit 1529-KOM i datës 16.03.2022 i Komisionit Disiplinor i Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregëtisë "Ndalim në pagë 20% në periudhën prej gjashtë(6) muajve".

### A r s y e t i m

Ankuesit \_\_\_\_\_ i punësuar në pozitën "Zyrtar për të hyra financiare" sipas Akt emërimit të datës 21.06.2019 në Agjencinë për Pronësi Industriale/ Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregëtisë, me datë 16.03.2022 Komisioni Disiplinor në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregëtisë me vendimin me numër protokollit 1529-KOM i shqiptohet masa disiplinore "Ndalim në pagë 20% në periudhën prej gjashtë(6) muajve".

I pakënaqur me vendimin e datës 16.03.2022 me numër protokollit 1529-KOM të Komisionit Disiplinor në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregëtisë, ankuesi me datën 08.04.2022



ka parashtruar ankesë përmes e-mailit me numër protokollit 1971/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës .

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës me datën 15.04.2022 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit tek Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregëtisë, ndërsa me datën 26.04.2022 Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë nga organi i punësimit së bashku me provat e bashkangjitura të lëndës.

**Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave për marrjen e vendimit meritator administroj këto prova:** Ankesën me numër A.nr.350/2022 me numër të protokollit 1971/2022 të parashtruar nga ankuesi me datën 08.04.2022 përmes e-mailit në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi i Komisionit Disiplinor i datës 16.03.2022 me numër protokollit 1529-KO i Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregëtisë; Akt emërimi i datës 21.06.2019; përkshkrimi i detyrave të punës për pozitën për të hyra financiare i datës 23.03.2017; **Vendimi i datës 20.08.2021** me numër protokollit 6024 për caktimin zëvendësues i Zyrtares së lartë për ekzaminim; Vendim i datës 25.11.2021 me nr.ref:02?Nr.277; Rregullorja Nr.29/2012 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregëtisë; Vendim i datës 20.08.2021 me numër protokollit 6025; Raport javor prej datës 23.08.2021 deri më datën 27.08.2021; Raport javor prej datës 06.09.2021 deri më datën 10.09.2021; Raport javor prej datës 13.09.2021 deri më datën 17.09.2021; Raport javor prej datës 03.10.2021 deri më datën 08.10.2021; Raport javor prej datës 15.11.2021 deri më datën 19.11.2021; Raport javor prej datës 23.11.2021 deri më datën 26.11.2021; Formulari i regjistrimit të ankesës; Ftesë e datës 24.08.2021 me numër protokollit 1507; Vendim për regjistrimin e dizajnit industrial; Përgjigje e kërkesës të datës 24.08.2021; E-mail zyrtar i datës 13.12.2021; E-mail zyrtar 17.11.2021; E-mail zyrtar i datës 19.11.2021; E-mail Zyrtar i datës 24.11.2021; E-mail zyrtar i datës 13.12.2021; E-mail zyrtar i datës 15.12.2021; E-mail zyrtar i datës 30.08.2021; E-mail zyrtar i datës 25.10.2021; E-mail zyrtar i datës 06.09.2021-kërkesë; E-mail zyrtar i datës 04.10.2021-njoftim; E-mail zyrtar i datës 05.10.2021-kërkesë për takim ; E-mail zyrtar i datës 02.11.2021-kërkesë për shqyrtim; E-mail zyrtar i datës 24.11.2021; E-mail zyrtar i datës 24.11.2021-kërkesë për trajnim; E-mail zyrtar i datës 19.11.2021 -Aktvendim i Gjykatës; E-mail zyrtar i datës 19.11.2021; E-mail zyrtar i datës 19.11.2021; E-mail zyrtar i datës 24.11.2021-kërkesë për shqyrtim; E-mail zyrtar i datës 22.11.2021 -kërkesë për shqyrtim; E-mail zyrtar i datës 28.11.2021; Trajnim mbi markat tregtare dhe procedurat e kundërshtimit; Plotësim i kërkesës për anulim diskrecional të vendimeve të API-së i datës 19.11.2021; Përgjigje në ankesë e datës 26.04.2022 me numër protokollit 2361/2022 nga organi i punësimit bashkë me shkresat e lëndës faqe 1/144; Akt emërimi i datës 21.06.2019; Përkshkrimi i detyrave të punës për pozitën "Zyrtar për të hyra" e datës 22.03.2017; E-mail zyrtar i datës 10.03.202; E-mail zyrtar i datës 09.03.2022; E-mail zyrtar i datës 28.02.2022; E-mail zyrtar i datës 25.02.2022-fletëparaqitje për fillimin e procedurave disiplinore ndaj zyrtarit

Inicimi i procedurës disiplinore për nga Zv. Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë për Pronësi Industriale; Vendim i datës 20.08.2021 me nr.6024 ; Procesverbali i seancës dëgjimore të Komisionit Disiplinor i datës 08.03.2022 ; Procesverbali i seancës dëgjimore të Komisionit Disiplinor i datës 14.03.2022 ; E-mail zyrtar i datës 15.03.2022 -ftesë për takim të komisionit Disiplinor; Procesverbali i seancës dëgjimore të Komisionit Disiplinor i datës 16.03.2022 ; E-mail zyrtar i datës 22.02.2022; E-mail zyrtar i datës 08.02.2022 -kërkese për informacione; E-mail zyrtar i datës 09.02.2022-kërkesë për informacione; E-mail zyrtar i datës 14.01.2022 -mungesë në punë; e-mail zyrtar i datës 24.11.2022 -kërkesë përshqyrtim ; E-mail



zyrtar i datës 23.11.2021 –kërkesë për shqyrtim; E-mail zyrtar i datës 24.11.2021 –kërkesë për sqarim ; E-mail zyrtar i datës 15.11.2021; E-mail zyrtar i datës 30.11.2021 –shprehje e pakënaqësisë; E-mail zyrtar i datës 05.10.2021- konfirmim i takimit; E-mail zyrtar i datës 29.12.2021-subjekt betonika; E-mail zyrtar i datës 25.02.2022 nga menaxherja e personelit; Mesazh origjinal i datës 24.02.2022 Propozim për fillimin e procedurave disiplinore ndaj zyrtarit

Mesazh origjinal i datës 29.12.2021; Kopja e Ligjit Nr.05/L-058 për Dizajnin Industrial; E-mail zyrtar i datës 23.11.2021 –kërkesa për shqyrtim; E-mail zyrtar i datës 22.11.2021; E-mail zyrtar i datës 19.11.2021 ; E-mail zyrtar i datës 17.11.2021; E-mail zyrtar i datës 14.12.2021; kërkesë për verifikimin e mallrave e datës 16.11.2021; Aktvendimi IV.EK.nr.640/21 i datës 14.11.2021 i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike; E-mail zyrtar i datës 17.11.2021-qasje në dokumente zyrtare; E-mail zyrtar i datës 24.11.2021 dhe E-mail zyrtar i datës 15.12.2021-vërejtje me shkrim.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara nga ankuesi dhe organi i punësimit, ka konstatuar se ankesa e ankuesit **është e pabazuar, sepse:**

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se vendimi me nr. 1523-KOM të datës 16.03.2022 i Komisionit Disiplinor i Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregëtisë me të cilin i shqiptohet masa disiplinore, “Ndalim në pagë 20% në periudhën prej gjashtë(6) muajve “ duhet të shfuqizohet sepse është në kundërshtim me Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik dhe Rregullores(QRK) Nr.04/2015 për Kodin e Mirësjelljes në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës me arsyetimin se unë nuk kam bërë asnjë shkelje të detyrave të punës pasi që në pozitën zëvendësues i zyrtares së lartë që gjendej në pushim të lehonisë kam qenë i caktuar të merrem me të hyra financiare, Dizajnë Industrial dhe tregues gjeografik, në të cilën pozitë kam qëndruar 75 ditë, ankuesi duke kundërshtuar vendimin e komisionit disiplinor thotë se unë nuk kam bërë asnjë shkelje. Po ashtu ankuesi e mohon se ka kundërshtuar të marrë pjesë në trajnime për Dizajne Industriale, nuk kam pasur sjellje jo korrekte ndaj qytetarit e ku përmendet subjekti Betonika duke cekur që nuk është e vërtetë që unë i kam ftuar palët me viber në takim . Ankuesi përveq tjerash në ankesë thekson se Zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm i Agjencisë për Pronësi Industriale mua qëllimisht ma delegoi lëndën e cila kishte të bënte me çështje juridike, ndërsa unë jam ekonomist. Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në bazë të provave të lëndës që posedon, konstaton se pretendimet e ankuesit për shfuqizimin e vendimit me nr. 1523-KOM të datës 16.03.2022 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregëtisë me të cilin i shqiptohet masa disiplinore, Ndalim në pagë 20% në periudhën prej gjashtë(6) muajve “ është i paqëndrueshëm.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka konstatuar se Vendimi i Komisionit Disiplinor me nr. 1523-KOM të datës 16.03.2022 është nxjerr në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Rregulloren (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë dhe Rregullores(QRK) Nr.04/2015 për Kodin e Mirësjelljes në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës. Ankuesi z. cili sipas Akt emërimit të datës 21.06.2019 ka qenë në pozitën Zyrtar për të hyra financiare në Agjencinë për Pronësi Industriale, ndërsa me vendimin me nr.ref.02/Nr.113 të datës 20.08.2021 të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregëtisë, caktohet zëvendësues i Zyrtares së lartë për ekzaminimin dhe njëkohësisht do të jetë edhe përgjegjës edhe për të hyrat financiare.



Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit të ankesës ka konstatuar se me datën 15.12.2021 i shqiptohet masa disiplinore "vërejtje me shkrim" nga mbikëqyrësi i drejtëpërdrejtë për shkak të moskryerjes së detyrave të punës e që ankuesi nuk ka paraqitur fare ankesë kundër vërejtjes. Bazuar në provat e lëndës, sidomos në komunikimet që ka pasur Zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Pronësisë Industriale, dukej se z. [ ] nuk i zbatonte urdhërat e eprorit të tij lidhur me kryerjen e detyrave të punës, kështu që për neglizhencën në punë, me datën 25.02.2022 mbikëqyrësi i drejtëpërdrejtë ka inicuar procedurë disiplinore me arsyetimin se [ ] vepronte në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrarët Publikë, Rregulloren (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrarëve Publikë dhe Rregullores (QRK) Nr.04/2015 për Kodin e Mirësjelljes në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës. Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka analizuar kërkesën e Zëvendësuesit të Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Pronësisë Industriale i cili pretendon se [ ] ka keqpërdorur detyrën zyrtare të tij të punës lidhur me shfuqizimin e një vendimi duke thirrur palët në takim pa qenë i autorizuar këtë e vërteton edhe e-maili i datës 29.12.2021 nga kompania betonikagarden.com. Po ashtu në kërkesën për iniciimin e procedurës disiplinore ceket se zyrtari në fjalë i cili ishte i ngarkuar të shqyrtonte rastin lidhur me kompanit që ishin të involvuara për Dizajn industrial, ka vënë në lajthitje edhe këshilltarin politik të Ministrisë dhe përfaqësuesit e kompanive duke dhënë informata të pabaza, të pasakta edhe të paqëndrueshme.

Ankuesi nga muaji gusht-nëntor është caktuar zyrtar i lartë për ekzaminim në vend të zyrtares e cila ishte në pushim të lehonisë por në muajin nëntor është larguar nga ky pozicion për shkak të refuzimit dhe shkeljeve për shqyrtimin e kërkesave të kërkuara nga mbikëqyrësi i drejtëpërdrejtë dhe në vend të tij caktohet një zyrtar tjetër, i cili i bënë presion pse e ka pranuar detyrën dhe ta bojkotoj punën në shqyrtimin e kërkesave për Dizajnë Industriale. Me datën 08.02.2022 kur zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm kthehej nga një takim jashtë Ministrisë, kur tentoj të hynte në zyre ka vërejt se dera ishte e mbyllur nga brenda ku kishte qenë z. [ ] bashkë me z. [ ] ku vërehej se në tavolin ishin prekur dokumentet. Të gjitha këto fakte të paraqitura në kërkesën e zëvendësuesit të Drejtorit të Përgjithshëm ankuesi i kundërshton por në bazë të provave të lëndës që posedojmë nga ankuesi dhe organi i punësimit Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka konstatuar se ankuesi i ka pranuar edhe në Procesverbalin e seancës dëgjimore nga Komisioni Disiplinor edhe në e-mailat e paraqitura.

Ankuesi [ ] për moskryerjen e punëve është ankuar se nuk ka kryer trajnime që kanë qenë të domosdoshme për Dizajnë Industrial, por kjo demantohet përmes emailit të datës 28.09.2021, po ashtu hedh akuza ndaj udhëheqësit për presion që i është bërë përmes e-maileve të datës 24.11.2021 dhe 30.11.2021 për shfuqizimin e vendimit për Dizajnin Industrial nr.116 të datës 13.08.2020 për rastin [ ]. Në të njëjtën kohë ka bërë shkelje duke ftuar dhe takuar me përfaqësuesit e kompanisë rreth shqyrtimit të vendimit për [ ], në hapësirat e bufësë së Ministrisë të cilët i ka ftuar në takim përmes komunikimit jo zyrtar (emailit) de pa e njoftuar eprorin. Ftesën për takim e ka bërë përmes Viber-it, e që dëshmohet përmes emailit të datës 29.12.2021 nga kompania Betonikagarden, andaj Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka konstatuar se Komisioni Disiplinor ka shqyrtuar me kujdes pretendimet e [ ] gjatë seancës së mbajtur me datë 08.03.2022 të cilat ishin kundërthënëse dhe në ndërkohë ankuesi nuk ka arritur t'i mbështes me prova dhe fakte konkrete.

Mbi bazën e fakteve dhe deklaratës në seancë dëgjimore të Komisionit Disiplinor, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka konstatuar se [ ] në pozitën zyrtar për të hyra financiare ka tejkaluar kompetencat në raport me mbikëqyrësin e drejtëpërdrejtë, andaj Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregëtisë ka konstatuar se ankuesi është përgjegjës për shkelje të rëndë disiplinore sipas nenit 46 paragrafi 3 nënparagrafi 3.3 dhe 3.10 dhe nenit 47 paragrafi 1, nënparagrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrarët Publikë ku përcaktohet se: " 3.3. moszbatimi i



dispozitave ligjore për përmbushjen e detyrave funksionale dhe 3.10. shkelja e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj dhe në legjislacionin në fuqi” dhe 1.2. ndalimi nga 20% deri në 40% e pagës për një periudhë deri në gjashtë muaj”, nenit 8 paragrafi 3 të Rregullores(QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publik ku përcaktohet se “3. Masat disiplinore të përcaktuara në nenin 47 paragrafin 1 nënparagrafi 1.2, 1.3 dhe 1.4 i Ligjit shqiptohen nga Komisioni Disiplinor, nëse nëpunësi civil ka bërë shkelje të dispozitave të përcaktuara në nenin 46 paragrafi 3 nënparagrafët 3.1 deri te 3.11 të Ligjit” dhe dispozitave të Rregullores Nr.045/2015 për Kodin e Mirësjelljes në Shërbimin Civil.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar se vendimi me numër protokolli 1529-KOM i datës 16.03.2022 i Komisionit Disiplinor i Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregëtisë “Ndalim në pagë 20% në periudhën prej gjashtë(6) muajve” është nxjerrë në pajtim me dispozitat e nenit 46, 47 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe nenit 8 të Rregullores(QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publik dhe dispozitave të Rregullores Nr.045/2015 për Kodin e Mirësjelljes në Shërbimin Civil.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 si dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
A.nr.350/2022, datë 20.05.2022

Sabile AVDYLI

*Sabile Avdyli*

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet:

- ❖ Ankuesit
- ❖ Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrinë Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregëtisë
- ❖ Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregëtisë dhe
- ❖ Arkivit të KPMSHCK-së.

